lajmi.net
Dëshironi të njoftoheni për lajmet më të fundit nga Lajmi.net?
Jo, falemindertë
Pranoj

Granatahedhës, armë, mjete shpërthyese: Prokuroria Speciale tregon çka u gjet nga bastisjet në veri

LAJME

14/10/2023 15:19

Policia e Kosovës që nga mëngjesi i së shtunës ka ndërrmarë një aksion në vazhdën e hetimeve për sulmin terrorist në Banjskë të 24 shtatprit.

Prokuroria Speciale ka dalë me komunikatë ku ka treguar aksionin që është ndërmarrë, shkruan Lajmi.net.

Sipas Prokurorisë më urdhër të tyre janë kontrolluar disa lokacione, në Mitrovicë të Veriut, në Zveçan dhe në Banjskë.

Nga Bastisjet në një bodrum në Mitrovicë të Veriut janë gjetur saë e madhe e arsenalit të armëve e municionit, 3 granatahedhës, 87 eksplozivë municion e armë të llojeve të ndryshme.

Njoftimi i plotë:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), dhe Policia e Kosovës (PK), njoftojnë opinionin publik se në vazhdën e angazhimit dhe realizimit të aktiviteteve policore për rrasje të rendit kushtetues, ofrimit të sigurisë dhe parandalimit të aktiviteteve kriminale, Policia e Kosovës, respektivisht njësitet relevante, sot kanë zbatuar urdhër kontrolli në pjesën veriore të vendit.

Prokuroria Speciale njofton se me urdhër të gjykatës, Policia e Kosovës ka zhvilluar kontrolle në shtatë lokacione në pjesën veriore të vendit, që lidhen me ngjarjet e 24 shtatorit 2023.

Po ashtu, ju njoftojmë se kontrollet janë kryer në lokacione të ndryshme, katër në Mitrovicën e Veriut, dy në Zveçan dhe një në Banjskë.

Gjatë këtyre kontrolleve, në një podrum të njërit nga tre soliteret në Mitrovicën e Veriut, janë gjetur një saë municioni, kallashnikovë, zola, eksplozivë etj.

Pjesëmarrës në këto kontrolle ishin edhe zyrtarë nga EULEX-i, kurse te tre rokadejët prezent kanë qenë edhe ECO -KFOR-i, po ashtu ECO e Policisë së Kosovës është në vend të ngjarjes.

Lista preliminare e armëve dhe pajisjeve tjera të sekuestruara:

- 87 copë eksplozivë të tipit TM 100
- 3 granata hedhës dore (zola)
- 1 armë automatike AK-47
- 1 minë kundër këmbësorisë e tipit MRUD
- 14 karikatorë
- Municion të kalibrave të ndryshëm
- 63 detonatorë elektrik
- 23 detonatorë mekanik
- 1 orë për aktivizim
- 1 granatë dore M7
- 3 tuba fitila ndezës
- Çanta, radiolidhje, antiplumba, pajisje medicinale, gyksore (jelek për bartje të karikatorëve), maskë kundër gazit, bateri etj.



LAJME TË FUNDIT

FSHF do të shpërblejë kombëtarën e Shqipërisë me 4.5 milionë euro

Gazetari i Top Channel për pak të vritet...

Bërnicë e Epërme, Bërnicë e Poshtme – bluatat...

Ballkani baraxon në miqësoren me Ukrainën

Artikuj të ngjashëm

October 14, 2023
Gazetari i Top Channel pak të vritet nga ushtarët izraelit...


October 14, 2023
Helmimi i 100 qytetarëve në Malishevë: AUV në lokal gjeti produkte...

October 14, 2023
Vitia për helmimin e 100 personave në një lokal në Malishevë:...

October 14, 2023
Helmimi me uthojm në Malishevë: Shkon në 100 numri i pacientëve

October 14, 2023
Aksioni i policisë në veri: Gjenden mjete shpërthyese në një bodrum

October 14, 2023
Me kërkesë të NATO-s, 130 ushtarë rumunë zbarkojnë në Kosovë

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved Privacy Policy